



REPUBLIKA ESHQIPËRISË

BASHKIA VLORË  
KËSHILLI I BASHKISË

Nr \_\_\_\_\_ prot

Vlorë, më \_\_\_\_ . \_\_\_\_ 2024

Procesverbal

Nr 8, datë 10.07.2024

I mbledhjes së këshillit të bashkisë, e cila zhvillohet në sallën e mbledhjeve në Pallatin e Kulturës “Labëria”( Ora 10<sup>10</sup> )

Marrin pjesë:

- |                      |                     |
|----------------------|---------------------|
| 1.Simo Petromilo     | 22.Shkëlqim Leskaj  |
| 2.Liljana Breshani   | 23.Bujar Osmanaj    |
| 3.Frosina Qyrdeti    | 24.Elca Bezhani     |
| 4.Edlira Kapllanaj   | 25.Marsela Dashi    |
| 5.Ervis Moçka        | 26.Arsen Belaj      |
| 6.Roland Strakosha   | 27.Geron Gunbardhi  |
| 7.Vullnet Bilbilaj   | 28.Myzafer Elezi    |
| 8.Novrus Rrokaj      | 29.Eglantina Aliaj  |
| 9.Simbol Pazaj       | 30.Ledja Shollaj    |
| 10.Aurora Qarri      | 31.Sokol Kushta     |
| 11.Klodian Xhyheri   | 32.Brikena Puka     |
| 12.Ardian Musta      | 33.Besmir Brahimi   |
| 13.Illir Aliaj       | 34.Brikena Sika     |
| 14.Englantina Imeraj | 35.Vjola Xhafaj     |
| 15.Lorel Canaj       | 36.Briseida Çakërri |
| 16.Endri Hyseni      | 37.Eda Begaj        |
| 17.Gjergji Nika      | 38.Erëmal Arapi     |
| 18.Rajmonda Zoto     | 39.Grigor Dede      |
| 19.Jerina Dervishaj  | 40.Anisa Ceno       |
| 20.Gëzim Çapoj       | 41.Alta Haluci      |
| 21.Edison Kapaj      | 42.Atird Hoxha      |

Mungojnë :

- 1.Elpiniqi Mërkuri
- 2.Evis Allushi
- 3.Eneida Vera
- 4.Refie Laze
- 5.Anxhela Shenaj
- 6.Dikens Bushaj
- 7.Liri Dëma
- 8.Arjan Isufi
- 9.Mujo Shakaj



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VLORE  
KËSHILLI I BASHKISË

Nr \_\_\_\_\_ prot

Vlorë, më \_\_\_\_ . \_\_\_\_ 2024

Procesverbal

Nr 8/1, datë 10.07.2024

Z.Novrus Rrokaj - Fillojmë këtë mbledhje jashtë radhe, kërkuar nga Kryetari i Bashkisë , me këtë rend ditë, 3 projektvendime (lexon)

Kush është dakort ?

Pro – 33 vota

Kundër – 0 vota

Abstenim – 0 vota

Miratohet.

Z.Gjergji Nika – Në Konferencën e Kryetarëve, nuk u miratua rendi i ditës, pasi unë dhe zoti Geron, kemi qenë kundër, pasi kemi kërkuar materialin e Ujësjiellit dhe Pikën, “Të ndryshme”

Z.Novrus Rrokaj – Kjo mbledhje është jashtë radhe. Rendi i ditës, është ky. Jemi në respekt të Rregullores. Vota e Kryetares së Këshillit, është vendimtare, ishim 3 me 3.

Z.Gjergji Nika – Unë dua një dakortësi me Kryetarin e Grupit, me zotin Moçka që, në mbledhjen tjetër të diskutohen të gjitha gjërat e lëna pezull, si informacioni për Ujësjiellin dhe, të gjitha kërkesat tona. Unë dua të marrë fjalën zoti Moçka, që të bjerë dakort për këto diskutime dhe informacione për mbledhjen e radhës.

Z.Ervis Moçka – Për procedurë. Çfarë ka në çështje procedurale.. ka pretendime pse nuk kalon ... Nuk ka pse bllokohet mbledhja e këshillit ,pse Konferenca e Kryetarëve votoi 3 me 3...

Këshilli vendos. Ka një rregullore, shumica vendos. Për procedurë . Ka një propozim që bie e ndesh me rregulloren. Kjo është mbledhje e thirrur nga Kryetari i Bashkisë, por nuk është e hajrit të priset kjo mbledhje, për diskutimet në Konferencën e Kryetarëve.

Z.Atird Hoxha – Për procedurë. Në mbledhjen jashtë radhe, kërkuar apo thërritësi i mbledhjes , duhet të jetë prezent të mbrojnë gjithë materialet. Propozimi im është, lexoni rregulloren. Për shkak të rregullores, ai që thërret mbledhjen, duhet të jetë prezent.

Z.Kozma Mali – PBA 2025 – 2027. Baza ligjore për hartimin e PBA ; pra Udhëzimi Nr 23/2018, Udhëzimit Nr 3/2024 “Për përgatitjen e PBA “, ju paraqesim relacionin për hartimin e PBA. Ky Program i është dërguar Ministrisë së Financave dhe, kanë ardhur rekomandimet. Një ndër

detyrat e Ministrisë së Financave , është shlyerja e detyrimeve të prapambetura dhe raportin e shpenzimeve ...Këto rekomandime erdhën pak me vonesë, prandaj e paraqesim sot në mbledhjen e këshillit bashkiak, i cili është një detyrim ligjor. Mbas kësaj do të bëhen dhe dëgjesta publike , për hartimin e programit përfundimtar. I kemi të sqaruara në relacion, është diskutuar dhe në mbledhjen e komisionit. Janë miratuar dhe tavanët buxhetorë.

Znj.Elca Bezhani – Në Komisionin e Financës, u diskutua PBA 2025 – 2027. Është zbatuar nga grupi i strategjik dhe Udhëzimi plotësues Nr 3/2024. Është bërë parashikimi i të ardhurave dhe burimet e tyre, shpenzimet dhe kostot , të ofrohen në dobi të qytetarëve.

Me vëmendje kam parë dhe rekomandimet e Ministrisë së Financave. Vërrej që PBA ishte konformë rregullave, por një këshillë e tyre, është rishikimi i raportit të shpenzimeve për investimet. Një rekomandim tjetër, kishte të bënte me borxhin e bashkisë, deri në vitin 2026, ta zerojë dhe në vitin 2027 do ta mbajnë në kontroll. Me diskutimet e bëra në komision , miratua që të kalojë në mbledhjen e këshillit për diskutim.(Bashkëlidhur relacioni )

Z.Gjergji Nika – Materiali është jashtë rregullores. Neni 159, ..lexon tavanet përgatitorë, duhet të ishin në 15 mars dhe brenda muajit maj, ne si këshill, do të bënim dëgjesat publike.I keni kaluar të gjitha hallkat. Nuk keni zbatuar rregulloren...Lexon.. Pse nuk keni dërguar tavanët përgatitorë , s'keni bërë dëgjesat publike...I keni kaluar këto hallka.

Znj.Alta Haluci – Disa pyetje në lidhje me PBA 2025 – 2027.

1.Bashkia Vlorë, ka një strategji afatgjatë. Si është parë kjo strategji ?

2.Pse bashkia nuk sjell relacion të detajuar ? Duhej një analizë shteruese për çdo zë.

3.Pse nuk janë bërë konsultimet publike?

4. Po ti referohesh tabelave , shoh që rriten shpenzimet për pagat

Pra, ti çoni paratë...,duke qenë se numri i punonjësve është rritur me 420 punonjës, më tepër.

-Detyrimet e prapambetura...Cila është arsyeja e mospagesës?

-PBA, nuk flet me shifra për turizmin, fondin, informacion zë për zë.

-Në lidhje me migracionin...për punësimin e të rinjve ?

-Sa rëndohet taksa dhe tarifa tek qytetarët

-A ka planifikuar diçka për Aleancën e Grave, ndonjë fond për zhvillimin e aktiviteteve?

(Bashkëlidhur , disa pika në nivel “Makro”)

Z.Novrus Rrokaj – Konsumuat dhe diskutimet. Le të flasë zoti Kozma.

Z.Kozma Mali – Tavanët janë diskutuar dhe kaluar në muajin mars. Dëgjesta publike janë bërë përgjatë vitit 2023.

Z.Gjergji Nika – Tavanët janë bërë. Sekretari të mbajë ëprgjegjësi që nuk janë dëgjesta publike.

Z.Daut Zëraj – Jeni i pasaktë. Dëgjesta bëhen, është ligj për çdo projektvendim, ndërsa për PBA do të bëhen mbas miratimit, dëgjesta publike.

Z.Ervis Moçka – Është miratuar me VKB Nr 27, Tavanët përgatitorë. Është miratim paraprak, jo final i PBA. Rekomandimet janë nga Ministria e Financave. Është i vetmi rekomandim, të shihet raporti midis shpenzimeve dhe investimeve. Pra, administrata të jetë e kujdesshme .

Z.Kozma Mali – Analiza që kërkoni ju, nuk është për këtë mbledhje. Na i sillni me shkrim pyetjet.

Z.Novrus Rrokaj – Kalojmë në votim.

Keni më diskutime ?

Znj.Alta Haluci – Problemi, fakti që problematikat e këshilltarëve diskutohen këtu ...Do tju'a nis me shkrim. Kam bërë disa kërkesa , kam kërkuar dhe interperlancë me Kryetarin e Bashkisë , por ngelën, s'kthehet përgjigje. Interperlancën, e kam kërkuar që në muajin shkurt. Pyetjet i kam nis, do ti sjell me shkrim.

Z.Gjergji Nika – Duhet të shikohet dhe PBA e vitit të kaluar. Nga tavanët përgatitorë ,kemi një kërcitje prej 63% krahasuar me vitin 2023. Në 2024 – 2026 , zëri shpenzime personeli 322 milion lekë.

→521 milion lekë për vitin 2025 – 2027, pra një kërcitje prej 63% , shpenzime personeli.

E njëjta gjë , rritje dhe për shpenzimet korente, me 40%...Pra, ka kërcitje të vlerave të të gjithë zërave.

Z.Illir Aliaj – Po i shikon gabim. Shpenzime personeli në vitin 2025, 521 milion, është parashikim ndërsa për vitin 2027, 527 milion.

Z.Gjergji Nika – 322milion ka ardhur. Unë sapo të mbarojë mbledhja , PBA e miratuar vjet për 2024 – 2026 dhe këtë të sotmin PBA 2025 – 2027 , do ti'a dërgoj KLSH-së .., vlerat 60-70% më të larta. Po ju jap shansin ta tërhiqni.

Ky projektvendim nëse do ta kaloni, unë do ti'a nis KLSH, ka probleme të theksuara. Ose është gabim PBA i vitit 2023 ose i vitit 2024. Ka probleme të theksuara, prandaj, tërhiqeni.

Z.Grigor Dede – PBA është një detyrim ligjor, që duhet të kishte ardhur , të kishte kaluar, por për shkak të vonesave , të rekomandimeve nga Ministria e Financave, po e kalojmë sot. Shifrat janë plan . Ky ndryshim që thotë zoti Nika, është gabim njerëzor, por duhet të pranojë se PBA bazohet në Ligjin Nr 68/2017, Ligjin Nr 9936 si dhe Udhëzimin Nr 7 si dhe Udhëzimit më të fundit. Ky PBA i ka shkuar Ministrisë së Financave, është studjuar prej saj, dhe në lidhje me Udhëzimin Nr 7, kjo ministri thekson, për disa korrigjime, në lidhje me uljen e shpenzimeve rrjedhëse dhe rritjes së shpenzimeve kapitale , ngelen në plan, këto shqetësime të zotit Nika. Ne do ta votojmë dhe zoti Nika, ta çojë ku të dojë.

Z.Gjergji Nika – Ministria e Financave, bën krahasimin midis dy viteve, i referohet PBA. Zotëria tha që, është gabim njerëzor..Idea është që , këto gabime njerëzore, janë me dashje. Këtu ka gabime të theksuara.

Z.Novrus Rrokaj – Prandaj bëhen diskutimet, që të rregullohen gjërat.

Z.Ervis Moçka – Zoti Nika faktoi që dy vite nuk rakordonin. Pra, nëqoftëse, këto shifra nuk rakordojnë, të bënte pyetje. Ka pas rritje page, ka pas shtim të numrit të punonjësve të Policisë bashkiake...I kemi mitatuar bashkë si rritjen e pagës dhe numrin e punonjësve. Dhe, nuk mund të themi sot, për rritjen e shpenzimeve të personelit. Sot është 521 milion, pritet VKM tjetër, kështu

që, me rritjen e pagave , rriten dhe shpenzimet e personelit. Pra, s'ka asnjë gabim. Zoti Nika, mund të kishte bërë pyetje që, pse ka ndoshur ky fakt, pra rritje e shpenzimeve të personelit.

Z.Gjergji Nika – Unë thashë, viti 2025 – 2026. Të gjitha kategoritë, kanë shpenzime personeli, shpenzime korente, shpenzime kapitale..Është ndryshuar gjithë PBA, ka një rritje prej 63% nga vjet , në sivjet.Verifikojeni, shikojeni dhe silleni të saktë.

Nëse shqetësoheni për qytetarët, duhet të shqetësoheni dhe për Ujësjellësin, që mos tu rriten taksat qytetarëve.

Z.Ervis Moçka – Po e sqaroj dhe njëherë.

Viti 2025, është parashikim, nuk është fakt 521 milion., ashtu dhe për 2026 dhe 2027 ...Po pritët VKM për rritjen e pagave . Është argument i kotë, zoti Nika.

Z.Novrus Rrokaj – E hedhim në votë.

Votohet.

Pro – 31 vota

Kundër – 11 vota

Abstenim – 0 vota

Miratohet.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VLORE  
KËSHILLI I BASHKISË

Nr \_\_\_\_\_ prot

Vlorë, më \_\_\_\_ . \_\_\_\_ 2024

Procesverbal

Nr 8/2, datë 10.07.2024

Z.Novrus Rrokaj – Pika 2 e rendit të ditës, projektvendimi “Për një ndryshim në VKB Nr 100, datë 29.12.2023”, i ndryshuar. Rikonstruksioni i Pallatit Nr 1300.

Z.Kozma Mali – Ky projekt ka ardhur me çmime reference të ndryshuara. Për emergjencë, pasi rrezikohet jeta e banorëve. Vlera e re nga Instituti i Ndërtimit është 10 milion 888 mijë ... me një shtesë prej 3 milion 321 mijë ...

Ky fond nuk do të prekë buxhetin e bashkisë, por nga fondi i prokurimit të rrugës “Gani Bejkosala”. Ishte 16 milion lekë/reja dhe u prokurua me një fond 12 milion lekë/reja.

Këto janë fonde të kursyera nga prokurimet publike, jo buxheti i bashkisë, llogaria në zërin “231”.

Z.Atird Hoxha – Ky projektvendim u diskutua dhe herën e kaluar, i cili u rrëzua. Dëgjova zotërinë dhe thotë që, nuk preket fondi i buxhetit. Fondi i kursyer nga prokurimet, mos ndoshta për rrugën “Gani Bejkosala”, kërkoni fond tjetër shtesë ?

Z.Kozma Mali – 16 milion fond limit.

Z.Atird Hoxha – A keni patur një tenderim për Pallatin 1300?

Z.Kozma Mali – Nuk ka pas, çmimet ishin të ulëta.

Z.Atird Hoxha – Kam parë Kryetarin me banorët e Pallatit 100...Ka pas prokurim për Pallatin 1300 ?

Z.Kozma Mali – Vjet, po. Sivjet do bëhet procedurë e re prokurimi.

Z.Klaudio Mehmeti – Ka patur një prokurim që është kryer në vitin 2023 dhe filluan punimet e pallatit. Nga ana e supervisorit, u nxorën disa problematika, në zbatimin e punimeve.

Z.Atird Hoxha – Mbi bazën e ekspertimeve të supervisorit dhe zbatimit të projektit. Çfarë masash keni marrë, lidhur me firmën zbatuese?

Z.Klaudio Mehmeti - Bazuar në këto difekte, ja nisëm Institutit të Ndërtimit, i cili na dërgoi preventiva të rinj, pra kemi zëra të rinj punimesh. Pra, kemi anulim procedurë.

Z.Atird Hoxha – Çfarë masash janë marrë me kontratën e lidhur?

Z.Klaudio Mehmeti – Është ndërprerë kontrata. Kjo nuk është problem, që nuk kemi ndjekur

procedurat..Këto janë çmime të reja, do bëhet tender i ri.

Z.Atird Hoxha – A ka njeri përgjegjës , kanë kaluar 3 vjet.

Z.Klaudio Mehmeti – Flas për periudhën, pas tenderimit.

Z.Atird Hoxha – Në procedurën e re, kjo firmë , mund të marrë pjesë ?

Mos ka kriterë përjashtuese për të tjerët ..Punonjësit.., a ka ndonjë përgjegjësi, ky problem ka 3 vjet.

Z.Gjergji Nika – Herën e kaluar na thatë që, pallati po bie, kalojeni me urgjencë. Unë shikoj që, punimet zënë 3% të preventivit.. Preventivi nga Instituti i Ndërtimit me vlerë, fondi 10 milion e ca . Mbi këtë bazë tenderi ...

Z.Klaudio Mehmeti – Është një komision që vlerëson ofertat.

Z.Daut Zëraj – Bazohet në ligj..., jo gjithmonë vlera më e vogël. S'është çështje për tu diskutuar në këshill.

Z.Grigor Dede – Çështja e Pallatit 1300, është çështje e ngritur nga qytetëtarët por edhe nga opozita. U kundërshtua herën e kaluar . Nga sa dëgjova zotin Mehmeti, është bërë procedura, nga eksperti në lidhje me punimet, i është bërë kërkesë Institutit të Ndërtimit dhe, kjo procedurë, priset, firmës i priset kontrata, do bëhet prokurim tjetër.

Pallati 1300 ka probleme, ky projektvendim është me emergjencë, nuk kaloi, pasi nuk ishte procedura e rregullt. Sot , po diskutojmë në mbledhjen jashtë radhe. Procedura është bërë para 1 viti, jo 3 vjet. Në lidhje me këtë projektvendim, ftoj dhe opozitën që, për këtë çështje jemi bashkë dhe, mendoj ta kalojmë për ta votuar.

Z.Geron Gunbardhi – Duhet ta votojmë. Vota ime është pro. ...Pse nuk thoni problemin real, pse e ndërlikoni. Do bëhet tender i ri, kaq është vlera ...

Z.Myzafer Elezi – Drejtori i Urbanistikës , në relacion, shuma për Pallatin 1300, do shkëputet nga projekti i Rrugës “Gani Bejkosala” A cënohen standartet e rrugës dhe në çfarë faze jeni?

-Ne si opozitë , nuk jemi kundër investimeve. Ne nuk e votuam për brendinë, por për formën.

Z.Klaudio Mehmeti – Nuk cënohet. Është lidhur kontrata për rrugën.

Z.Ervis Moçka – E para, kjo çështje nuk është as për të majtë e as për të djathtë. Do ta votojmë të gjithë. Ka ligj, ka proceduradhe administrata të nxjerrë përgjegjësia , nëqoftëse, ka pas dëme dhe vonesa në kurriz të qytetarëve. Sot jemi para faktit.Ka ardhur një material i Institutit të Ndërtimit, ka ardhur një fond , ka ngelur nga prokurimi dhe ti kalojë këtij pallati. Mos të ngrihen hamendësime.

Z.Novrus Rrokaj – Kalojmë në votim.

Z.Atird Hoxha – Për procedurë, kisha një pyetje. Rruga “Gani Bejkosala “, ka kaluar. Ju e keni shpall si procedurë, por jo fituesin. Meqenëse pretenduat .., është konsultim i tanishëm.., vlera 141.510 mijë lekë/vjetra.

Z.Kozma Mali – Është mbyllur procedura, por APP ka bllokuar procedurat në sistem dhe, do hidhen më vonë në sistem. Firma fituese është ”Caushi M”.

Z.Novrus Rrokaj – Votohet.

Pro – 42 vota

Kundër – 0 vota

Abstenim – 0 vota Miratohet.





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA V Lorë  
KËSHILLI I BASHKISË

Nr \_\_\_\_\_ prot

Vlorë, më \_\_\_\_ . \_\_\_\_ 2024

Procesverbal

Nr 8/3, datë 10.07.2024

Z.Novrus Rrokaj –Pika 3 e rendit të ditës, projektvendimi “Për miratimin e korridorit ujqor për subjektin operator turistik detar , Altin Gjondedaj”. Drejtori Juridik.

Z.Dorian Demiri – Projektvendimi është një kërkesë e administratës për miratimin e korridorit ujqor për operatorin turistik që ushtron aktivitetin në zonën e Radhimës.

Baza ligjore për hartimin e këtij projektvendimi:

-VKM Nr 171 ; VKM Nr 321 ; Vendimi Nr 2/2020 ; VKM Nr 845 .

Është bashkëpunim midis Drejtorisë së Kufirit, Kapitenerisë dhe administratës..Kemi brë dhe dëgjesë publike.

Z.Myzafer Elezi - E lexova projektvendimin. A është konsultuar stafi juaj me VKM Nr 285/2022 “ Për kriteret e vendosjes ...”, sepse kjo VKM , nuk është cituar si bazë ligjore .

Bashkia jep vetëm korridore ujqore. Ju lutem, ndryshoni kokën e projektvendimit, jo dhe “vendbazimin “

Z.Dorian Demiri – Është vetëm korridor ujqor, jo vendbazim.

Z.Endri Hyseni – Ta shohim dhe njëherë propozimin e zotit Elezi. Ta rregullojnë. Propozojmë të miratohet me propozimin e zotit Elezi, të hiqet “vendbazim” dhe të ngelet vetëm si korridor ujqor.

Z.Myzafer Elezi – I propozoj këshillit ta miratojmë me ndryshimin..Të miratohet .... e korridorit ujqor për subjektin ..., të hiqet termi “ dhe vendbazimin “.

Z.Gjergji Nika – Propozimi i zotit Elezi, erdhi nga kërkesa e zotit Grigor, që mos të ngelet operatori pa aktivitet tani në sezonin turistik. Materiali ka ardhur i kopsitur, me gjithë dokumentacionin bashkëlidhur. A ka mundësi që të vijë 5 minutat e fundit material i ....

Z.Ilir Aliaj – Mendoj të bëhet dhe një ndryshim tjetër, i vogël. Pra, se, merret sot material i korridor ujqor dhe më vonë merret si pikë për të tretë. Domethënë, ndryshimi, duhet bërë që ...

Z.Dorian Demiri – Ajo gjë nuk ndodh, sepse ka liçensë si operator turistik.

Z.Ilir Aliaj – Operatori do punojë , me mjetet , pronën e tij, jo si pikë me të tjerë.

Z.Dorian Demiri – Mendoj që, nuk është e domosdoshme, pasi ka liçensë si operatot turistik.

Nuk i lejon Drejtoria e Kufirit.

Z.Daut Zëraj – Ti jep korridorin, jo mjetin.

Z.Dorian Demiri – Përderisa, operatori ka liçensë, nuk dalim mbi ligjin.

Znj.Brikena Puka – Ka ndodhur ajo gjë, ka marrë mjete të tjera.

Z.Atird Hoxha – Ky ndryshim që propozoi zoti Aliaj dhe zoti Elezi , e cënojnë tërësinë e tij ?

Z.Dorian Demiri – Për korridoret , po, jo vendbazimin

Z.Atird Hoxha – Jemi para faktit , që dalin mjete të tjera.

Z.Dorian Demiri – Thjesht, vendosen tapat, korridoret...Përsa i përket ...

Z.Atird Hoxha – Subjekti është shpallur fitues në datën 08.07 dhe është hedhur në faqen e APP...Kjo është 24 milion lekë. E sollët dhe herën e kaluar. Kur është lidhur kjo kontratë , në çfarë date ?

Z.Dorian Demiri – Tek faqja e APP-së keni dhe njoftimin, por si procedurë, mbase ka nisur shpejt.

Z.Atird Hoxha – Pra, në lidhje me ndalimin e APP-së, për prokurimet, në lidhje me firmën fituese, për Rrugën “Gani Bejkosala “, për ti dhënë fond Pallatit 1300..Kur është lidhur kontrata për rrugën “Gani Bejkosala “?

Z.Novrus Rrokaj – Ta hedhim në votë, me ndryshimin , “vendbazim” të hiqet, me propozimin e zotit Elezi?

Votohet

Pro – 42 vota

Kundër – 0 vota

Abstenim – 0 vota

Miratohet.

Z.Illir Aliaj – Po me propozimin tim?

Z.Novrus Rrokaj – Bie në kundërshtim me ligjin.